



# Lajmëtari i Radio Marisë



Janar - Prill 2015, Viti VII, Nr. 1

## Për shumë vjet Pashkët!

Të dashur miq të Radio Marisë!

Njeriu e dëshiron jetën e pasosur. Jezusi “**që e kaloi tokën duke bërë mirë**”, është ringjall.

Më dhuratën e Ringjalljes së Jezusit, fati njerëzor është Jeta, e jo më vdekja. Si të krishterë të mburremi me ngjarjen që të gjithëve na solli shëlbimin, me të kremten e Pashkëve.

Për çdo ditë takohemi me paraqitje të tmerrshme të vdekjes; por gjëja edhe më tragjike është kur në kohën tonë takohemi me **kulturën e vdekjes**, për të cilën shumë shpesh foli edhe Papa Shën Gjoni Pali II e që tashmë nuk e ka pushtuar vetëm **qytetërimin perëndimor**, por u bë pikë e dhimbshme edhe këtu në mesin tonë.

Gjatë shtegtimit tonë tokësor, me ngjizje na u dhurua jeta, ndërsa me pagëzim na u dhurua jeta e amshuar. Duke kremtuar Misterin e pashkëve, dëgjojmë porosinë të cilin na jep Zotëria i ringjallur: “**Jeta dhe vdekja në dyluftim, u përleshën mrekull’ shqim, Prijësi i jetës vdekur ra, por u ngjall sundon pa nda**”! (Kthesa e Pashkëve). Kjo porosi na nxit që të besojmë me qëndrueshmëri në vlerën e amshuar të jetës njerëzore që fillon me ngjizje; ndërsa me pagëzim hapat para amshimit.

Krishti i ngjallur le të bëhet dritë për të gjithë njerëzit që e kërkojnë të vërtetën dhe kuptimin e ekzistencës së

tyre! Çdo personi në shpirt le t’i shndrisë shpresa e Ringjalljes, kurse në zemër le t’i arrijë fjala të cilën Krishti ia drejton secilit: **Paqja me ju!**

Në raste të ndryshme Jezusi iu shfaq dishepujve të vet, deri ditën e të ngjiturit të tij në qiell. Në shumë mënyra tregoj se është i gjallë dhe ju foli për Mbretërinë e Hyjit. Një gjë mund të duket e çuditshme: ungjilltarët në asnjë vend nuk e kanë shënuar se Jezusi iu shfaq edhe Marisë, nënës së vet. A mos ishte e nevojshme që kjo gjë të thuhej? A thua me të vërtetë Jezusi nuk iu shfaq Nënës pas ngjalljes? Në këtë gjë nuk duhet dyshuar aspak, për të ajo është krijesa më e dashur mbi tokë, ajo është Nëna e tij, dhe pikërisht për këtë gjë ajo ishte e para që pati mundësi pas mundjes së vdekjes ta përqafojë Birin.

Të krishterët në të gjitha kohërat, kësaj Nënë në kohën e pashkëve ia kushtuan këngën e lavdit dhe të gëzimit që e këndojnë të lutur në kohën e Pashkëve: Mbretëreshë e qiellit, gëzohu, Se ai që meritove për ta mbartur, u ngjalla si pati thënë. Alilluja.

Nënë e dashur, Mari, ji ti ylli i mëngjesit që do ta shndrisë udhëtimin e bijve dhe bijave të tua këtu mbi tokë drejt amshimit të lumtur.

Të gjithë nga zemra ju uron festën e Pashkëve.

I juaji Don Preka



### Solemniteti i Zojës Nunciatë

- nga Imzot Ottavio Vitale -

faqe 2

### Po kthehem tek Ati!

- Nga Don Albert Demaj -

faqe 3

### Nëntë vite vullnetar

- Nga Antonio Qyrsaqi -

faqe 5

# Solemniteti i Zojës Nunciatë

**25 Mars 2015**

Faqja e mrekullueshme ungjillore e lajmërimit të engjëllit Marisë se do të bëhej Nëna e Shëlbuesit ka ngjallur gjithmonë një devocion të veçantë ndaj këtij misteri të madh që kremtohet çdo vit me 25 mars, nëntë muaj përpara lindjes së Zotit.

Hyji nuk ka dashur të hyjë në botë me forcë: ka dashur të “propozohet”. “Po-ja” e Marisë është realizim përfundimtarë i Besëlidhjes: në të është i pranishëm i gjithë populli i premtimit: i vjetri (Izraeli) dhe i riu (Kisha); “Zoti është me të”, domethënë Hyji është Hyji ynë dhe ne jemi përgjithmonë populli i tij.

Kur Hyji, për të na shpëtuar vendosi të jetonte mes nesh, në gjendjen tonë, me mish e gjak, dhe një jetë njerëzore si të tonën, deshi të kishte një nënë. E zgjodhi jo mes grave më të pasura të botës apo mes atyre më aristokratike të Romës apo të Athinës, por mes një populli besimtarë, mes atyre më të vitytshme dhe të shenjta.

Hyji, i cili respekton gjithmonë lirinë e njeriut, e dërgoi Krye-engjëllin Gabriel të pyeste Marinë nëse pranonte të bëhej Nëna e Shpërblyesit.

Maria e hapi shpirtin në tërë gjërësinë dhe thellësinë e tij për të pranuar vullnetin e Hyjit, planin e tij hyjnor të shëlbimit, pa u kujdesuar për gëzimet dhe vuajtjet që do t'i kishte shkaktuar misioni si Nënë e Mesisë.

Duke pranuar mesazhin e Hyjit me shpirt të hapur, Maria bëhet Nëna e Hyjit dhe bashkpunëtore e Shpërblyesit. Kështu, skena e Lajmërimit përbën ngjarjen më të madhe dhe më të rëndësishme të historisë njerëzore. Ajo është në qendër dhe në majë të të gjitha ngjarjeve njerëzore, të të gjitha dëshirave të vërteta të njerëzimit.

Njerëzit që kanë ekzistuar para ditës së Lajmërimit prisnin dhe dëshironin në mënyrë të flaktë ardhjen e Mesisë dhe të gruas që do ta linte, për t' shpëtuar nga mëkati; dhe të gjithë njerëzit që kanë ardhur dhe do të vijnë pas, nëse duan të shëlbohen, duhet të njohin dhe të jetojnë shembullin e Jezusit dhe të Nënës së tij.

Të qënurit Nënë të Marisë, përveç dimensionit hyjnor, si Nënë e Hyjit,

ka marrë edhe një dimension njerëzor, duke u bërë Nënë e njerëzimit. Ky dimension i dyfishtë zbulohet, në mënyrë të mrekullueshme dhe madhëngjyese, në dasmën e Kanës. Kur në momenti më të rëndësishëm të banketit mungonte vera, Nëna e Jezusit, që, sikurse çdo nënë e mirë kishte sy të kujdesshëm, mbeti e çuditur por jo e çorjentuuar; ndjeu ndaj tyre një dëshirë

amore ndihme. Sytë e sajë kaluan të menduar nga bashkëshortët tek i Biri, prania e të cilit i zbulonte dhe i kujtonte shumë ngjarje hyjnore në jetë, dhe, e vendosur, përshpejtoi në mënyrë amnore ndërhyrjen e të Birit.

Ja se si Maria zbulohet vërtetë si Nënë e Hyjit, duke përshpejtuar gjithpushtetësinë për të marrë një mrekulli; është me të vërtetë Nëna e njerëzve, e të gjithë familjes njerëzore, drejt së cilës ka dashuri e kujdes shpirtëror të patregueshëm. Maria, nëna e Jezusit, lutet, ndërmjetëson, fiton edhe mrekulli dhe bashkpunon me Birin e sajë për të na shëlbuar, dhe me Shpirtin Shenjtë për të na shenjtëruar.

Çdo grua që bëhet nënë, qet në dritë fëmijën e vet me dashuri e dhimbje të mëdha. Çdo fëmijë, nëse do të mundte, do tia lehtësonte nënës çdo vuajtje. Jezusi, fryti hyjnor, u shkëput nga gjiri i Marisë sikurse fruti i pjekur shkëputet nga dega pa e thyer. Edhe ky fakt i mrekullueshëm dhe hyjnor na zbulon dhe vërteton identitetin e Marisë si Nënë e Hyjit. Vetëm, gjatë lindjes në Betlehem, Maria e pranoi me dashuri të pafund fëmijën Jezus në krahët e sajë, e mbështolli me ëmbëlsi amnore, e vuri në grazhd sikurse mbi një fron, dhe u gjuhëzua ta adhuronte, e lume, si Hyjin e sajë dhe Birin e sajë.

Të bashkpunojmë edhe ne me këtë vepër amnore dhe hyjnore të Marisë me apostullatin e shembullit, të lutjes dhe të veprimit për shumë vëllezër tanë që nuk besojnë. Duke na përsëritur në çdo Meshë: “Bëni këtë në përkujtimin tim”, Zoti na mëson t’ua “japim” edhe ne trupin dhe gjakun tonë vëllezërve. Vetëm kështu e bëjmë të besueshëm shëlbimin e Hyjit, duke e mishëruar në “po-të” e vogla që çdo ditë përsërisim mbi shembullin e Marisë.



**Imzot Ottavio Vitale**

## Po kthehem tek Ati!

Koha e Kreshmeve është kohë e hirit të veçantë, kohë e kthimit tone shpirtërorë tek Ati. Mu për këtë arsye ne organizuam seminarin një javorë me don Prekën, i cili seminarin e titulloi: Po kthehem tek Ati!

Seminarin filloj të hënën më 9.3.2015 në Qendrën e Misionit tone në Sirnach. Pasi që këtu po thuajse të gjithë punojnë, seminari duhet patjetër të mbahet në mbrëmje. Pra, edhe pse njerëzit të lodhur nga puna, dhe shumë larg nga Misioni ynë, ata nuk prituan që gjatë tërë javës të flijohën vetëm e vetëm të vijnë të dëgjojnë don Prekën, që aq bukur i shpjegonte gjërat, i frymëzuar nga Shpirti Shenjt.

Ne seminarin fillonim në 18.30 me rruzarën shenjte. Për të vazhduar me pas me ligjeratat e don Prekës, me nga një pauzë të shkurtër. Në ora 21 h kishim meshën me predikim. Edhe pse ishte vonë, dhe kishte njerëz që ishin larg nga Misioni ata prap se prapë qëndronin për të biseduar me don Prekën, kërkonin këshilla, lutje. Dhe krejt kjo tregon etjën dhe urinë që besimtarët kanë për Zotin.

Don Preka ligjeratën e parë e filloi me Veprat e Apostujve duke pyetur: pse Luka e shkruan këtë vepër? Kush është Teofili, të cilit ia dedikon veprën e vet Luka? Teofili – Miku Hyjit, jemi të gji thë ne, ose duhet të jemi të gjithë ne. Dhe përse Luka e bënë këtë? Për t'ia treguar Krishtin, për ta dërguar tek Krishti? Pastaj don Preka pyeti: Cila është dhurata më e madhja për ju nga Zoti? Meshtari dhe motrat që aq shumë bëjnë për ju. Çka ata bëjnë për ju, cili është qëllimi tyre? T'ju tregojnë Krishtin, t'ju qojnë tek Krishti. Mjerisht ka shumë të krishterë që nuk e duan një gjë të tillë, nuk duan të shkojnë dhe të jetojnë me Krishtin. Paramendoni, sa shumë ju punoni këtu 6 ditë të plota e ka nga ata që punojnë edhe 7 ditë edhe nga dy punë dhe nuk ju mjafton. E sikur të angazhoheshim kaq shumë për Krishtin, për shpirt, sa më të lumtur do të ishim?

Pastaj don Preka me një mjeshtri të rrall filloj të shpjegojë Urdhërimet e Zotit dhe pyeti: Sa sot Zoti vërtet ka qenë Zoti im? Sa sekonda, minuta i kam kalua me Të? A i kam thënë sot Zotit me zemër: Ti je Zoti im!

Si t'i dallojmë zotat e rrejshëm? Çdo gjë që shpenzojmë kot, është një zot i rrejshëm! Çdo gjë që e zënë vendin e Zotit në zemrat tona, e shkatërron jetën tonë. Por Zoti nuk vjen me dhunë, Zoti e nderon lirinë tonë. Por ne duhet të kuptojmë se vetëm atë që Zoti sjell në jetën tonë, është e vërtet dhe e rëndësishme për shëlbimin tonë.

Pastaj don Preka pyeti: kush e pengon besimin tonë? Mendja. Në fe, në besim duhet me vu në pikëpyetje mendjen? Ju e dini si reagon Krishti tek shumimi bukëve? Sa bukë keni? 5 bukë, por çka janë këto për tanë këta njerëz? Pra, apostujt logjikojnë me kokë, realisht

ashtu është, por megjithatë, në fjalën e Krishtit, buka nuk mbaron, sepse të gjithë ngihën dhe buka tepron?! Në mendjen tonë, vërtet përfundojnë gjërat, por në Zotin kurrë, a e beson ti këtë? Pastaj ne duhet të pranojmë të padukshmën. Ne mjerisht e pranojmë vetëm atë që shihet, që duket? Pse kur vdes njeriu, trupin e tij e largojmë prej shtëpije, sepse trupi edhe pse shihet nuk ka vlerë pa shpirtin që nuk shihet?!

Pastaj ne duhet me mohu botën e vjetër dhe me ndërtua botën e re! Në dhomën e pritjes nuk mund të sjellish gjëra të reja, pa i larguar të vjetrat!

Lexues i nderuar, kështu don Preka, çdo mbramje, në mënyrë shumë të thjeshtë dhe praktike i nxite besimtarët tanë të mendojnë, të thellohën në jetën e tyre dhe të gjëjnë forcë për t'u kthyer tek Ati.

Të premtën ishte ftesa e Papës 24 orë me Krishtin. Dhe ne pas udhës së kryqit dhe meshës, vazhduam adhurimin deri në mesnatë, ku prania e popullit ishte e madhe.

Dua me këtë rast të falënderojë stafin e Radio Marisë në Shkodër që ka bërë transemtimin e drejtpërdrejt të këtij adhurimi duke ju mundësuar dëgjuesve të nderuar të jenë pjesëmarrës të këtij adhurimi.

Të shtunën po ashtu kemi bërë adhurim tërë ditën dhe kemi pas rrëfimet. Ishte kënaqësi e veçantë për mua si meshtarë, besimtarëve të mi, nepërmjet rrëfimit shumë të sinqert t'ju mundësojë kthimin tek Ati. Me disa ndërprerje të vogla kam rrëfyer nga ora 9 e mëngjesit deri në ora 21.30 kur kemi filluar meshën. Ishte lodhje por më shumë kënaqësi e gëzim, kur shihja dëvotshmërinë dhe sinqeritetin e besimtarëve tanë para Zotit.

Të dielën, 15.3.2015. ishte mesha në kishën e shën Kollit në Eëill, që ul i nxënë 750 vet. Por atë ditë njerëzit kanë mbetur edhe për jashta, në mungesë të hapësirës në kishë. E falënderoj z Arben Preka,


besimtarin tonë që ka mundësuar bashkë me stafin e Radio Marisë në Shkodër transemtimin e drejtpërdrejt të kësaj meshe.

Në emër të besimtarëve tanë dhe në emrin tim, falënderojë nga zemra don Prekën për çdo fjalë, e çdo gjë të mirë që gjatë këtyre ditëve ka bërë për besimtarët tanë. Po ashtu një falënderim edhe për Orselinën, që ka qenë gjithmonë e gatshme për të ndihmuar besimtarët tanë, sidomos që në bashkëpunim me stafin e Radio Marisë në Shkodër kanë bërë ingjizimin e seminarit dhe besimtarëve ju kanë dhuruar në Cd meditimet e don Prekës.

Të gjithë atyre që kanë kontribuar në mbarëvajtjen e seminarit, faleminderit. Zoti ju shpërbleftë me të mira.

Për shumë mot Pashkët!

**Don Albert Demaj.**



## Nëntë vite vullnetar

Te jesh vullnetarë është diçka shumë e bukur dhe e veçantë nëse jetohet siç duhet. Që prej 9 vitesh unë jam vullnetar i Radio Marisë dhe prej 5 vitesh vullnetar i oratorit “Don Bosko Shkodër.” Si fillim dua të jap përkufizimin e vullnetarizmit: “Vullnetarizmi është konsideruar si një aktivitet altruist dhe përpiqet të promovojë mirësinë ose të përmirësojë cilësinë e jetës. Si shpërblim, ky aktivitet mund të ndihmojë në vetëvlerësim dhe në respekt.”

Si kam hyrë në Radio Mari?

Shumë thjeshtë. Duke dëgjuar radion, duke marrë pjesë në emisionin për fëmijë, duke vizituar radion së paku një herë në javë. Së pari ishte shtytja dhe nxitja e prindërve, pastaj kam vazhduar me punën vullnetare deri më sot.

Jam vullnetar i Radio Marisë që në moshën 9 vjeçare dhe ajo që kam bërë deri tani ju siguroj që nuk është vetëm një aktivitet për të tjerët që promovon mirësi, por është edhe aktivitet që ka ndërtuar, të them ashtu, personin tim.

Për mua puna vullnetare në Radio Mari është thirrje e Zotit për tu shpallur të gjithëve fjalën dhe dashurinë e tij. Në çastin kur punën vullnetare fillova ta kuptoja si thirrje ajo u bë një pjesë e rëndësishme e jetës sime e cila më formoi dhe vazhdon akoma ta bëjë këtë gjë. Në këmbim të punës vullnetare nuk mora vetëm respektin apo vetë-vlerësimin por mora atë që është më e rëndësishmja, dashurinë e Zotit dhe njohjen e vetes.

Aktiviteti i parë në Radio Mari ishte lutja e rruzares së Zojës. Kjo ditë ishte ditë e veçantë për mua. Po flisja në Radio dhe po

lutesha së bashku me shumë njerëz të tjerë. Asnjë herë nuk me shkoi në mend ta pyes veten përse shërbimi im filloi me lutje, them të drejtën, deri tani këtë gjë e kisha harruar plotësisht. Duke kujtuar ditët e para në Radio Mari, vërej se përvoja ime e parë këtu ishte lutja të cilën e përsërisim më shpesh. Kështu kuptova që pa lutje puna vullnetare këtu tashmë do ishte shuar. Kuptova që në ditën e parë, kur luta rruzaren, Zoja më mori për dore për të më shoqëruar në ecjen timen. Pastaj u bëra drejtues i emisionit të fëmijëve. Ishte ndjenjë e bukur të bëhesh i vetëdijshëm që vetëm i ulur pran një mikrofoni duke treguar për historinë e Kishës po kryeja një vepër të Hyjit. Po mësoj vetë dhe po i mësoja të tjerët për historinë e nuses së Krishtit, Kishës. Tani drejtoj edhe emisione të tjera siç janë: “Të lutemi me Don Boskon” dhe “Pak tinguj zemre”.

Kur i kujtoj vitet e mia në Radio Mari mendoj: “E fillova me lutje, e vazhdova me lutje dhe me emisionin e fëmijëve, dhe e vazhdoj akoma me lutje dhe me dy emisione të tjera që i përmenda pak më lartë.” Fjala lutje s’ka munguar dhe nuk mungon kurrë. Zoti e ka menduar mirë ecjen time këtu në Radio Mari dhe e ka ditur shumë mirë që Radion do ta quaja familja ime.

Puna vullnetare është një vepër dashurie që gjithmonë ka për qëllim zbatimin e vullnetit të Zotit. Puna vullnetare nuk më solli thjeshtë respekt apo vetë-vlerësim, por jetë më të mirë, një jetë ndryshe, për të tjerët dhe për Zotin.

**Antonio Qyrsaqi**



## Programi ditor bazë i Radio Marisë

00	:	00	Rruzarja me Atin e shenjtë Benediktin XVI Misteret e gëzimit
00	:	30	Leximi i Biblës Besëlidhja e Re - Don Preka
01	:	00	Programi sipas ditëve përkatëse
02	:	00	Rruzarja misteret e dritës
02	:	30	Leximi i librit - Orselina
03	:	00	Meditimi 5 minuta me Zotin - Don Preka; Rruzarja misteret e mundimit
04	:	00	Meditimi i mëngjesit, Don Preka
05	:	00	Rruzarja misteret e lumturisë
05	:	30	Leximi i Biblës Besëlidhja e Re - Don Preka
06	:	00	Leximi meditativ i librit të përngjamët e Krishtit
06	:	25	Kushtimi i Radio Marisë
06	:	30	Ta fillojmë ditën me Jezusin paraqitja e shenjtit të ditës - Orselina
06	:	50	Meditimi 5 minuta me Zotin - Don Preka
07	:	00	Paraqitja e njetit dhe e programit të ditës
07	:	05	Lutja e mëngjesores
07	:	30	Mesha, Falënderimi pas Kungimit
08	:	20	365 Historitë e Biblës Erisa dhe Oltiani
08	:	30	Rruzarja për miqtë & bamirësit e Radio Marisë
09	:	00	Meditimi i mëngjesit - Don Preka
10	:	00	Lidhja me Prishtinën
11	:	00	Leximi i librit - Orselina
11	:	30	Leximi i Biblës Besëlidhja e Re Don Preka
12	:	00	Meditimi 5 minuta me Zotin - Don Preka; Paraqitja e programit dhe lutjet: Mbretëresha e qiellit, Ora e mesme dhe rruzarja
13	:	00	Leximi meditativ i librit të përngjamët e Krishtit
13	:	30	Emisioni për fëmijë
14	:	00	Për të gjithë nga pak – Leonida & Flora
15	:	00	Kurorëza në nder të Mëshirës Hyjnore dhe shërbesa e leximeve
15	:	30	365 Historitë e Biblës Erisa dhe Oltiani
16	:	00	Lidhja me Prishtinën
17	:	00	Lajmet Emanuela
17	:	10	Presim telefonatat tuaja për të paraqitur falënderimet dhe njetet për të cilat do të lutemi në rruzare
17	:	50	Meditimi 5 minuta me Zotin - Don Preka
18	:	00	Mesha dhe mbrëmësorja nga - Prishtina
19	:	00	Emisioni për fëmijë
19	:	30	Presim telefonatat tuaja për të paraqitur falënderimet dhe njetet për të cilat do të lutemi në rruzare
20	:	00	Programi kryesor sipas ditës përkatëse
21	:	00	Rruzarja për njetet e dëgjuesve
21	:	35	Lajmet nga Radio Vatikani
22	:	10	Lutja e pasmbrëmësorës - Orselina
22	:	30	Leximi i librit - Orselina
23	:	00	Programi i orës 20

## Programet që ritransmetohen Natën

### DIEL

Ora 01 Personazhe që duhen kujtuar  
Ora 04 Shpjegimi i fjalës së Zotit - Don Preka

### HËNË

Ora 01 Urdhërimet – Mons. George Frendo; Sakramentet - Motër Mimoza  
Ora 04 Paraqitja e Fjalës së Zotit dhe meditimi i saj - Don Preka (enjte)

### MARTË

Ora 01 Të vërtetat e fesë së krishterë, Don Dominiku  
Ora 04 Të përtërihemi në Zotin - Motër Rita

### MËRKURË

Ora 01 Meditimi 15 minuta për ty, Don Preka  
Ora 04 Enciklikat: Shën Gjoni Pali II nga Don Lorenzo, Heshtja e Marisë - Orselina, Fjala për të jetuar, Fokolarinët, Veneranda

### ENJTE

Ora 01 Kisha dhe shoqëria - Atw Lovro Gavran: Përshpirtëria Karmelitane, - Atë Mario Jeta e krishterë, Don Leonardo; Ungjilli i Jetës – Motër Maria Katerina  
Ora 04 Paraqitja e Fjalës së Zotit dhe meditimi i saj - Don Preka (e hënë)

### PREMTE

Ora Fjala e Zotit në Besëlidhjen e Vjetër - Atë Ndue Kajtazi; Ipeshkvi në studio, Mons Angelo Massafra;  
Ora 04 Të rinjtë kërkojnë thesarin, Motër Miki

### SHTUNË

Ora 01 Magjisteri i Kishës, Don Preka; Vatra Biblike - Lezhë  
Ora 04 Paraqitja e Fjalës së Zotit dhe meditimi i saj - Don Preka (e marte)

## Programet kryesore të ditës

### DIEL

Ora 14:00 Meditimi 15 minuta për ty - Don Preka  
Ora 18:30 Të mësojmë të lutemi me Don Boskon - Antonio  
Ora 20:00 Enciklikat: Shën Gjoni Pali II nga Don Lorenzo, Heshtja e Marisë - Orselina, Fjala për të jetuar – Fokolarinët - Veneranda (një herë në muaji)

### HËNË

Ora 09:00 Paraqitja e Fjalës së Zotit dhe meditimi – Don Preka (leximet e ditës)  
Ora 20:00 (1) Kisha dhe shoqëria P Lovro Gavran: (2) Pershoirteria Karmelita, Atë Mario; (3) Jeta e krishterë, Don Leonardo; (4) Ungjilli i Jetës Maria Katerina; (të hënëve sipas radhës)

### MARTË

Ora 09:00 Paraqitja e Fjalës së Zotit dhe meditimi i saj - Don Preka (leximet e ditës)  
Ora 20:00 (1) Magjisteri i Kishës, Don Preka; (2) Vatra Biblike - Lezhë

### MËRKURË

Ora 19:00 Të rinjtë kërkojnë thesarin, Motër Miki  
Ora 20:00 Fjala e Zotit në Besëlidhjen e Vjetër - Atë Ndue Kajtazi; Ipeshkvi në studio; Mons Angelo Massafra – (një herë në muaji)

### ENJTE

Ora 09:00 Paraqitja e Fjalës së Zotit dhe meditimi i saj - Don Preka (leximet e ditës)  
Ora 20:00 Urdhërimet - Mons George Frendo; Sakramentet - Motër Mimoza

### PREMTE

Ora 14:00 Përshpirtëria e udhës së kryqit  
Ora 20:00 Të përtërihemi në Zotin - Motër Rita; Portrete shenjtërisht - Don Dritani

### SHTUNË

Ora 09:00 Paqja e zemrës – Motër Elizabeta (një herë në dy javë)  
Ora 14:00 Personazhe që duhen kujtuar – Dr. Florenci  
Ora 20:00 Shpjegimi i fjalës së Zotit - Don Preka (leximet e ditës së diele)

**Lajmëtari i Radio Marisë**  
është organ i  
Shoqatës Radio Maria.

**Tiranë**

Rr. Papa Gjon Pali II, Nr. 4  
Fushë Kërçik, Babrru, Paskuqan  
Tiranë, Shqipëri  
+355 4 2 346 346

**Shkodër**

Sheshi Papa Gjon Pali II  
Shkodër, Shqipëri  
+355 22 24 08 52

**Lezhë**

Sheshi Besëlidhja  
Lezhë, Shqipëri  
+355 215 24 970

E-mail: [info@alb.radiomaria.org](mailto:info@alb.radiomaria.org)  
Facebook: Radio Maria Albania  
Përgjegjës: Don Prekë Lazraj

**Radio Maria,**  
**Hiri i Hyjit në shtëpinë tënde,**  
mund të dëgjohej në:

Rrëshen e rrethina  
**FM 100.7 MHz**

Tiranë, Durrës, Kavajë, Berat  
**FM 91.4 MHz**

Shkodër, Podgoricë, Ulqin  
**FM 102.2 MHz**

Lezhë, Laç të Kurbinit, Mamurras  
**FM 89.6 MHz**

Pukë, Fushë Arrëz, Tropojë,  
Kukës dhe Kosovë

**FM 90.0 MHz**  
në internet

[www.radiomaria.al](http://www.radiomaria.al)

## Çfarë thonë dëgjuesit për Radio Marinë:

### Sokoli Tiranë

RM është buka jonë e përditshme,

### Irena

S'ka fjalë për Radio Marinë veç falënderim.

### Lena

Radio Maria më ka bërë të ndryshoj mentalitetin, mënyrën e besimit, të mos hakmerrem, më ka dhënë qetësi, më ka përtërirë zemrën. Radio Maria është falënderimi i zemrës sime.

### Marku

Falënderoj Zotin për Radio Marinë tonë. Më bënë përshtypje emisioni i fëmijëve, rruzarja me Zvicrën, i ftoj të gjithë ta përjetojnë mrekullinë që e jetojmë ne duke dëgjuar Radio Marinë.

### Laureta Greqi

Të gjitha emisionet më pëlqejnë, meditimet, emisionet e orës 20.00; 5 minuta me Zotin. Mundohem ta përtypi çdo gjë që dëgjoj.

### Maria

Falënderoj Zotin për emisionet e Radio Marisë, emisioni i Imzot Gjergj Frendos më pëlqen shumë, 5 minuta me Zotin, për të gjithë nga pak.

### Mira Ulqin

Falënderoj Zotin për emisionet që nuk mbarojnë ditë as natë, Zoti ju rrit pushtetin, meditimet, telefonatat, gjithçka është ngushëllim për mua. Po mësojmë se si ta marrim kryqin dhe të ecim përpara.

### Mirlinda

Jetoj në Zvicër dhe kam mundësi ta dëgjoj Radio Marinë, është gëzim që nuk kalon dhe më përtërinë mua dhe familjen time.

### Filja

Falënderoj Zotin për shijen që e marrim në Radio Mari, kalojmë halle dhe stresse duke dëgjuar lutjet, Meshën, rruzaren

kur e lusin fëmijët si në Zvicër si në Shkodër. Falënderojmë Zotin për gjakun e Martirëve.

### Luçi

Falënderoj Zotin për atë farë që nëna e ka mbjellë në zemrën time dhe më dha shembullin për ta dëgjuar Radio Marinë, e lus Zotin për të, sepse nuk kisha ditë çka është besimi, jeta, të duash... e shumë të tjera. Këtë ma mësoi Radio Maria, universiteti jonë.

### Violeta

Radio Maria për mua është jetë. Përpara se ta dëgjoja Radio Marinë jeta ime ishte a të jetoj apo të vdesë! Falë Radio Marisë jetoj. Falënderoj Zotin për burrë, vajza me fëmijë që shoqërohen me Radio Marinë. Qetësia e shpirtit tonë jeni ju. Nuk mund të jetoj pa të.

### Lezja Zvicër

Për mua Radio Maria është Kisha, Mesha, lutja, mësimi që nuk na mungon asnjë moment. Zoti ju rrit pushtetin e bekoftë dhe e përhaptë kudo në botë Radio Marinë.

### Maria Tiranë

E falënderoj Zotin që e ka mundësuar dëgjimin e Radio Marisë në familjen time. Përshtypja për RM: s'ka fjalë për ta përshkruar atë që përjetohej, emisioni i Motër Mikit, Don Robertit, emisioni i përshtypjeve e ka një vlerë të madhe, sepse shohim se sa mrekullitë i bëri Zoti në jetën e njerëzve.

Përmes Radio Marisë Zoti e dhuron Fjalën, pastaj fjala vepron në zemër.

Radio Maria më mësoi se si ta filloj ditën me Jezusin, lutjen, të marrë pjesë në Meshë, emisionet, çdo gjë që dëgjojmë na ndihmojnë ta jetojmë të përditshmen që me çdo gjë që e jetojmë na drejton kah Zoti. Lehtësohemi. Jemi çdo ditë në shkollën e dijës që na dhuron Radio Maria.

### PRO CREDIT BANK

LLOGARIA NË EURO 600388970102  
Kodi SWIFT: FEFAALFR  
IBAN: AL45209516090000600388970102

LLOGARIA NË LEK 600388970001  
Kodi SWIFT: FEFAALFR  
IBAN: AL56209516090000600388970001

### INTESA SANPAOLO BANK

LLOGARIA NË EURO 1043631803  
Kodi SWIFT: USALALTR  
IBAN: AL25208110080000001043631803

LLOGARIA NË LEK 1043631801  
Kodi SWIFT: USALALTR  
IBAN: AL 79208110080000001043631801

### NË ZVICËR

Verein Freunde vom albanischen  
Radio Maria

Appenzeller Kantonalbank

Konto: 90-125-8

IBAN:  
CH86 0076 3000 1157 2414 5